



COMUNE DI PLATACI
(PROVINCIA DI COSENZA)
BASHKIA E PLLATËNIT
(PROVINÇA E KOZENCËS)
C.A.P. 87070

Tel 0981 54011 – Fax 54100 – C.F. 81001370782 – P.I. 00468100789

E – mail: comunediplateci@libero.it

www.comune.plataci.cs.it

FESTIVALI I KËNGËTARËVET TË VEGJËL ARBËRESHË

RREGULLORJA

1. Administrata e Bashkisë së Pllatënit, me suportin e Sportelit Gjuhësor Bashkiak organizon çdo vit një shfaqje këngësh e emërtuar “Festival i këngëtarëvet të vegjël arbëreshë”, të përfaqësuar nga një simbol me emërtimin e festivalit dygjuhësh, i paraprirë nga numri progresiv i vitit të organizimit.
2. Shfaqja është e rezervuar për djem dhe vajza që në datën e shfaqjes nuk kanë kaluar moshën katërmëdhjetëvjeçare (14), qoftë solistë, qoftë grupe muzikore.
3. Këngët (teksti dhe muzika) duhen të jenë të pabotuara dhe të shkruara në arbërisht dhe/ose shqip, me zgjatje jo më shumë se 5 minuta.
4. Çdo këngëtar ose grup muzikor mund të marrë pjesë në festival vetëm me një këngë për të cilën është interpretues dhe protagonist.
5. Kërkesat për pjesëmarrjen, që duhen të jenë shkruar në formularin përkatës, duhen të përmbajnë të gjitha të dhënat e kërkuara dhe duhen të arrijnë në Bashkinë e 87070 PLATACI (CS) – Zyra e Sportelit Gjuhësor – brenda datës 19 korrik dhe jo më vonë, përveç siç është parashikuar në nenin e pastajmë nr. 18.
6. Për pjesëmarrjen duhet t’i bashkëngjitet kërkesës:
 - n. 1 CD përfundimtare, me regjistrimin e këngës, që pastaj do të jetë e shfrytëzuar për realizimin e CD-së së festivalit;
 - n. 1 CD përfundimtare, vetëm me bazën muzikore të këngës së propozuar;
 - teksti përfundimtar i këngës së propozuar me përkthimin italisht, në file, në format “.rtf” / “.doc”, që mund të dërgohet edhe me e-mail në adresën: comunediplateci@libero.it, me objekt “Festivali i katërt i këngëtarëvet të vegjël arbëreshë”;
 - vërtetim njohjeje me fotografi, i lëshuar nga Bashkia e vendbanimit;
 - kërkesa e pjesëmarrjes duhet të jetë e nënshkruar nga ai që ushtron pushtetin atëror.

7. Materiali i dërguar nuk do të kthehet mbrapa në asnjë mënyrë dhe pjesëmarrja ngërthen pranimin e vendimeve me karakter teknik-organizativ, që organizimi do të marrë edhe pas kësaj rregullorje.
8. Komiteti Organizues do të njoftojë datën e caktuar për ekzekutimin e çdo kënge me një komunikatë shtypi në sitin e Bashkisë. Gjithashtu, Komiteti Organizues rezervon të drejtën të ndajë shfaqjen në një ose dy mbrëmje në funksion të kërkesave funksionale të lidhura me numrin e pjesëmarrësve.
9. Të gjithë pjesëmarrësit marrin pjesë në shfaqjen vetëm duke qenë të pranishëm e mund të jenë të shoqëruar nga një bazë, nga një kor dhe nga një ose më shumë muzikantë; për kë shoqëron (një këngëtar) nuk vlejné kufizimet e neneve të mëparshme 2 e 4.
10. Një juri popullore, e përbërë nga jo më pak se pesë ekspertë të këngës arbëreshe, do të votojë këngët në garë dhe do të japë çmimet nga 1 në 3 të nenit 12. Një juri teknike, e përbërë nga jo më pak se pesë ekspertë të lëndës, do të votojë këngët në garë dhe do të japë çmimet nga 4 në 8 të nenit 12. Një grup llogaritjeje, i përbërë nga tre pjesëtarë për të cilin një merr përgjegjësinë, merret me sisteme llogaritjeje objektive për të regjistruar skedat dhe për të formuar klasifikimin final.
11. Çdo pjesëtar i jurivet do të ketë në dispozicion një skedë me të dhënat e këngëtarit dhe të këngës dhe një seri e numëruar me dhjetë katrorë dhe do të shprehë në të, në formë anonime, një notë nga 1 në 10 në shenjë të katrorit përkatës. Skeda, paraprakisht e mbyllur nga juristi, do të jetë e tërhequr nga një përgjegjës që në mënyrë të qartë do t'ia dorëzojë një grupi llogaritjeje që do të merret me formimin e klasifikimit; klasifikimi, i nënshkruar nga përgjegjësi i grupit të llogaritjes, do të jetë shpallur për fituesit nga paraqitësi i festivalit në fund të mbrëmjes dhe tërësisht me afishimin në tabelën e lajmërimeve të Bashkisë.
12. Këto janë çmimet:
 1. € 500,00 atij që zë vendin e parë;
 2. € 300,00 atij që zë vendin e dytë;
 3. € 200,00 atij që zë vendin e tretë;
 4. € 100,00 + targë për çmimin e kritikës;
 5. € 100,00 + targë për çmimin e muzikës më të mirë;
 6. € 100,00 + targë për tekstin më të mirë;
 7. € 100,00 + targë për interpretimin femëror më të mirë;
 8. € 100,00 + targë për interpretimin mashkullor më të mirë;

Të gjithë këngëtarët do të kenë një medalje si kujtim.

Tri çmimet e para, të zgjedhura nga juria popullore, do të jepen sipas radhës me meritë në bazë të klasifikimit; në rast klasifikimi me të njëjtat pika për dy ose më shumë konkurrues,

këto çmime do të jepen pas një garë të mëtejshme (shfaqje tjetër dhe votim tjetër) nga meritat e barabarta dhe një përcaktim tjetër të klasifikimit, me rrjedhje, në mënyrë që për çdo çmim do të jetë vetëm një fitues. Në rast barazimi të mëtejshëm, pas garës, do të vazhdohet me hedhje në short, në skenë. Çmimet nga n. 4 në n. 8, të zgjedhura nga juria teknike, do t'u japin me të njëjtën metodë, pa nevojë rriedhjeje të klasifikimit, në konsideratë të çmimeve të ndryshëm.

Saktësohet se fitimi i njerit nga tri çmimet e para të dhënë nga juria popullore lejon automatikisht përjashtimin nga çmimet të dhënë nga juria teknike.

13. Një ose më shumë iniciativa me karakter reklame, mund të jenë të çiftëzuara me festivalin dhe me përhapjen e tij të mundshme televizive dhe/ose radiofonike.
14. Të gjithë të drejtat që kanë të bëjnë me regjistrimet dhe transmetimet e ekzekutimeve janë të rezervuara, për qëllime jo komerciale, pa që u përket ekzekutuesëve asnjë shpërblim.
15. Konkurruesit që vijnë nga jashtë do të kenë një maksimum prej € 200,00 si pagim i shpenzimeve.
16. Të drejtat e ekzekutimit, përhapja dhe incizimi i këngëve në garë janë të rezervuara për Komitetin Organizues.
17. Organizimi nuk merr asnjë përgjegjësi për dëme të çdo lloji të shkaktuara pajisjeve personale të konkurruesëve, nuk merr gjithashtu asnjë përgjegjësi civile dhe/ose penale për kontestime të mundshme për faj të të tretëve dhe/ose të pjesëmarrësve në lidhje me përmbajtjen artistike e teksteve dhe të muzikës, edhe përsa i përket rastit të ekzekutimit të copave që nuk janë të pabotuara.
18. Organizimi mund të bëjë ndryshime dhe integritet në rregulloren e tanishme, për të mbrojtur nivelin artistik të mirë dhe organizativ të festivalit, pa ndryshuar qëllimet.
19. Pjesëmarrja në festival supozon njohjen dhe pranimin e rregullores së tanishme.
20. Rregullorja e tanishme, formulari i pranimi dhe informacione të tjera për Festivalin e katërt i këngëtarëve të vegjël arbëreshë janë të disponueshëm on-line në sitin internet: www.comune.plataci.cs.it. Për sqarime të ndryshme mund të kontaktoni Zyrën e Sportelit Gjuhësor – Sekretaria Organizative – me telefon +39 0981 54011 – faks +39 0981 54100 – e-mail: comunediplateci@libero.it

Pllatën, prill 2008

Kryetari i Bashkisë
Av. TURSI Francesco